




ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

# PËRMBLEDHJE

**SUBJEKTI I MONITORUAR: LULJETA KOLE,  
GJYQTARE, GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR  
KORÇË**

Raportim paraprak i seancës  
dëgjimore të datës 20/10/2022,  
realizuar pranë KPK

- ✓ **Kriteri i pasurisë: U kërkuan  
shpjegime shtesë për disa prej  
pasurive të paluajtshme dhe të  
luajtshme të rivlerësuar**
- ✓ **Vlerësimi i aftësive profesionale:  
Raport pozitiv nga KLGJ, por 8  
denoncime të publikut, u  
vlerësuan nga trupa gjyquese  
pa rëndësi thelbësore.**
- ✓ **Vlerësimi i kontrollit të figurës  
konfirmoi përshtatshmërinë e  
subjektit në kryerjen e detyrës**



## NJOFTIM I PËRMBLEDHUR

### Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Znj. Luljeta Kole, përballet me rivlerësimin nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK)

Me datë 20.10.2022 ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Znj. Luljeta Kole, Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për shkak të funksionit si gjyqtar, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim ligji nr. 84/2016).

Trupa gjyquese përbëhet nga Firdes Shuli (Kryesuese), Olsi Komici (Relator) dhe Valbona Sanxhaktari (Anëtare), si dhe asistuar nga vëzhguesi ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

Në seancën dëgjimore të monitoruar, u konstatua se KPK ka përfunduar hetimin administrativ për të tri kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Gjithashtu KPK relatoi se subjekti i rivlerësimit është njoftuar për: (i) rezultatet e hetimit kryesisht (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr.84/2016 dhe për të sjellë prova për të provuar të kundërtën; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 – 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjatë seancës dëgjimore, pas relatimit të çështjes nga KPK, fjalën e mori subjekti i rivlerësimit, duke prapësuar kundrejt konstatimeve të hetimit administrativ si dhe duke realizuar mbrojtjen mbi barrën e provës që ishte kaluar nga KPK. Referuar nenit 52 të Ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i ishte kaluar barra e provës për:

- **Kriterin e pasurisë:** Pasurinë e paluajtshme apartament ndodhur në Korçë, ku sipas KPK subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pjesën takuese të bashkëshortit prej 25%. Për blerjen e një automjeti në shumën 300,000 Leke, nuk është deklaruar burimi i krijimit të ardhurave
- Nga KLGJ ishte dorëzuar raport pozitiv sa i përket vlerësimit të **aftësive profesionale**. Ndaj subjektit rezultoi se janë depozituar 8 denoncime nga publiku, të vlerësuar nga ana e trupës gjyquese si pa rëndësi thelbësore; 5 ankesa të depozituara në Inspektoriatin e ish-KLD, për të cilat katër janë arkivuar dhe një ankesë është pezulluar. Vendimarrja në një çështje penale nga subjekti i rivlerësimit dhe të ndryshuar nga Gjykata e Apelit Korçë, ishte kaluar si barrë prove dhe u prapësua nga subjekti i

rivlerësimit se vendimi i saj kishte qenë i drejtë dhe ishte bazuar në rrethanat e çështjes dhe bindjen e saj të brendshme.

- **Vlerësimi i kontrollit të figurës** konfirmonte përshtatshmërinë e subjektit në kryerjen e detyrës.

Subjekti i rivlerësimit në fjalën përmbyllëse, falenderoi KPK për një hetim të drejtë dhe kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca për shpalljen e vendimit u caktua me datë 21.10.2022 ora 09:45.